



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3978 prot.

Shkodër, me 19.02.2026

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër”, miratuar me Vendimin Nr.60, datë 28.12.2020, njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak ditën **Premte** datë **27.02.2026 ora 15:00**, me rendite si më poshtë:

Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 26.01.2026 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 pika 2.

1. *Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2026”.*
2. *Projektvendim: “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”.*
3. *Projektvendim: “Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak Shkodër në Këshillit e Qarkut Shkodër”.*
4. *Projektvendim: “Për në ndryshim në VKB nr.54 datë 30.09.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”.*
5. *Projektvendim: “Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2027-2029”.*
6. *Projektvendim: “Për miratimin e shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe*

programit buxhetor 2026-2028”, si dhe për përcaktimin e destinacionit të përdorimit të fondeve të akorduara të grantit të bazuar në performancë për vitin 2025.

7. *Projektvendim: “Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 84 datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, projekti ‘Shtëpia që ndërton të ardhmen – Rikonstruksion i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç).*
8. *Projektvendim: “Për miratimin e Udhëzuesit të Aplikimit “Për zbatimin e skemës së granteve për biznese inovative, 2026 – 2028”.*
9. *Projektvendim: “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat e tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar.*
10. *Projektvendim: “ Për një ndryshim në VKB nr.18 datë 20.07.2023 “Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore “PrueMos Sheldi”, Nësia administrative Gur i Zi, fshati Sheldi, ngastra 104, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërinë “Volta Albania” i ndryshuar.*
11. *Projektvendim: “Për miratimin e planit lokal të veprimit për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike 2026-2036”.*
12. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve

Nr.	Komisione	Dita	Data	Ora
1.	Komisioni i Shërbimeve Sociale dhe Strehimit	E Martë	24.02.2026	11:00
2.	Komisioni i Rendit Publik dhe Mbrojtjes Civile	E Martë	24.02.2026	11:30
3.	Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujrave dhe Mbrojtjes së Mjedisit.	E Martë	24.02.2026	12:00
1.	Komisioni i Çështjeve Ligjore	E Martë	24.02.2026	13:00
2.	Komisioni i Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike/Komisioni i Kontrollit Financiar	E Martë	24.02.2026	13:30

Duke Ju falënderuar,

KRYETAR

